



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1155

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Auto Europa Cars SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve te MSH-se RITENDER me numër të prokurimit 206-25-8990-2-2-1, me 28/01/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Auto Europa Cars SH.P.K. me nr. 2025/1155 , e datës 25/11/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve te MSH-se RITENDER me numër të prokurimit 206-25-8990-2-2-1.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E SHËNDETËSISË, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve te MSH-se RITENDER me numër të prokurimit 206-25-8990-2-2-1.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Auto Europa Cars SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 06.10.2025 KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve te MSH-se RITENDER me numër të prokurimit 206-25-8990-2-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 91,000.00 €.

Me 05.11.2025 MINISTERIA E SHËNDETËSISË, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), u është rekomanduar për kontratë OE "Gani Krasniqi B.I"

Me 07.11.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 17.11.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 25.11.2025, OE Auto Europa Cars SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1155, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhenie të kontrates.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Auto Europa Cars SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

PRETENDIMET ANKIMORE 1

Auto Europa Cars sh.p.k. & N.T.SH. EUROPA – Batri Ademi B.I. ka pranuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së më 05.11.2025, ku jemi shpallur të pasuksesshëm në këtë aktivitet të prokurimit, e që vlerësojmë dhe konsiderojmë se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, duke mos e vlerësuar, krahasuar dhe ekzaminuar dosjen e OE të rekomanduar për kontratë në mënyrë të duhur.

Gjithashtu, vlerësojmë se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së, pika 4.1:

4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve.

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

Ne, pasi që kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, kemi vërejtur se AK-ja ka shkelur në mënyrë flagrante nenin 69 të LPP-së, paragrafi 4.1:

4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve.

Në vijim do t'i shtjellojmë një nga një.

Në dosjen e tenderit është kërkuar, citojmë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë stafin profesional për realizimin e kontratës, si në vijim:

Tre (3) automekanikë;

Një (1) inxhinier i mekanikës me diplomë të nivelit bachelor;

Një (1) inxhinier i elektroteknikës me diplomë të nivelit bachelor.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Për 3 automekanikë kërkohen kopje të diplomave të shkollës së mesme, kopje të kontratave ose parakontratave me punëdhënësin.

Për inxhinierin e mekanikës dhe inxhinierin e elektroteknikës kërkohen: kopja e diplomës (niveli bachelor) dhe kontrata ose parakontrata me punëdhënësin.

OE ka ofertuar me inxhinier të elektroteknikës z. Bujar Gjocaj, për të cilin ju sigurojmë dhe garantojmë se këtë parakontratë nuk e ka nënshkruar personalisht dhe nuk ka qenë fare në dijeni për parakontratën e OE Gani Krasniqi B.I.

Ne kemi ofertuar edhe në një aktivitet tjetër të prokurimit, ku jemi konkurrentë së bashku me OE Gani Krasniqi B.I., të iniciuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe aty ka qenë parakontrata pikërisht me z. Bujar Gjocaj si inxhinier i elektroteknikës, ku dy parakontratat ku ka ofertuar në MMPHI dhe Ministrinë e Shëndetësisë kanë nënshkrimin identik, ku asnjë milimetër nuk ndryshon.

Provë – parakontrata MMPHI ku ka ofertuar:

Pra, kjo është parakontrata në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë e z. Bujar Gjocaj, e prezantuar nga OE Gani Krasniqi B.I.

Ndërsa në vijim e keni parakontratën e z. Bujar Gjocaj në Ministrinë e Shëndetësisë, të cilën OE Gani Krasniqi e ka dorëzuar me nënshkrim COPY-PASTE nga parakontrata e MMPHI-së, ku ka ofertuar më herët.

Provë – parakontrata në Ministrinë e Shëndetësisë:

Duke i shikuar dhe analizuar parakontratat, shihet qartë se nënshkrimet janë marrë COPY-PASTE dhe nuk kemi një parakontratë reale, por kemi të bëjmë me mashtrim në prokurim publik.

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

Këto në vijim janë nënshkrimet e OE Gani Krasniqi B.I., i cili ka ofertuar në Ministrinë e Shëndetësisë me COPY-PASTE, pa nënshkrime reale.

Këto në vijim janë nënshkrimet e parakontratës së OE Gani Krasniqi B.I. në MMPHI, të cilat janë mbuluar me marker të zi nga AK-ja, pasi që kanë qenë sekret afarist.

Siç shihet te nënshkrimi i z. Bujar Gjocaj, asnjë milimetër nuk ka ndryshim në nënshkrimin e tij në dy aktivitete të ndryshme të prokurimit. Këtu konstatohet se nuk kemi parakontratë reale ndërmjet dy palëve.

Ky është mashtrim me prokurim publik dhe falsifikim i dokumentacionit dhe në këtë rast, gjithashtu, kërkohet nga OSHP-ja të iniciojë rastin konform nenit 99.2 të LPP-së për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurim publik.

Ne e kemi siguruar e-mailin zyrtar të z. Bujar Gjocaj dhe numrin e telefonit. Ne i kemi dërguar më 05.11.2025 e-mail z. Bujar Gjocaj, i cili është Drejtor i Gjinnazit “Gjin Gazuli” në Prishtinë, se a është në dijeni se OE Gani Krasniqi B.I. ka dorëzuar parakontratë me ju në Ministrinë e Shëndetësisë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Servisimi i automjeteve të MSH-së RITENDER” dhe numër të prokurimit: 206-25-8990-2-2-1.

Provë – e-maili i dërguar më 05.11.2025 dhe i pranuar më 06.11.2025

Auto Europa Cars sh.p.k. ka pranuar e-mail nga z. Bujar Gjocaj në e-mailin e kompanisë sonë dhe më poshtë e kemi të konfirmuar e-mailin edhe me foto të e-mailit, ku konfirmohet se është nga z. Bujar Gjocaj, inxhinier i elektroteknikës.

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

Siç shihet, inxhinieri i elektroteknikës z. Bujar Gjocaj në e-mailin e kompanisë sonë më 06.11.2025 na përgjigjet si vijon:

Përshëndetje të nderuar!

Unë nuk kam ndonjë parakontratë me askënd për këtë tender dhe ajo kopje nuk është nga unë, vetëm nëse është ndonjë parakontratë tjetër për të cilën unë nuk jam në dijeni.

Gjitha të mirat!

Pra, z. Bujar Gjocaj e konfirmon pretendimin tonë ankimor se OE ka bërë mashtrim me prokurim publik.

Z. Bujar Gjocaj aktualisht është Drejtor i Gjinnazit “Gjin Gazulli” në Prishtinë dhe është person me integritet dhe i respektuar në shoqëri dhe në rrethin ku jeton dhe vepron. Andaj, qëndrimi i tij duhet marrë për bazë, pasi OE Gani Krasniqi B.I. ka shfrytëzuar diplomën e tij pa dijeninë e tij dhe parakontratën, dhe është konstatuar se nuk e ka nënshkruar ai për këtë aktivitet të prokurimit.

Pra, siç vërehet nga e-maili, z. Bujar Gjocaj nuk ka pasur fare njohuri dhe OE, pa e informuar dhe pa u dakorduar, e ka vendosur parakontratën e tij në këtë aktivitet të prokurimit.

Edhe një herë kërkohet nga OSHP-ja të veprojë konform nenit 99.2 të LPP-së dhe të bëjë diskualifikimin nga pjesëmarrja në prokurim publik për operatorin ekonomik Gani Krasniqi B.I., pasi ka paraqitur të dhëna të rreme, ashtu siç parashihet në nenin 99.2, të cilat janë të argumentuara dhe të konstatuara.

Provë – neni 99, pika 2 e LPP-së

Neni 99

Funksionet dhe Kompetencat e OSHP-së

OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji dhe ka autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë pjesë.

Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Në vijim i keni të dhënat e z. Bujar Gjocaj, ku edhe ju si AK mund të komunikoni me të:

E-mail: bujargjocaj78@gmail.com

Tel: 044 123 301

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit dhe që të shpallet fitues Auto Europa Cars sh.p.k. & N.T.SH. EUROPA – Batri Ademi B.I. si OE më i lirë i përgjegjshëm.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e paraqitura më lart, në dëshmitë e dorëzuara, në shkeljet e konstatuara të neneve 59, 61, 69 dhe 99 të LPP-së, si dhe të nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 002/2024, konsiderojmë se ankesa jonë është plotësisht e bazuar si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik.

Autoriteti Kontraktues ka dështuar që të kryejë vlerësim të drejtë, objektiv dhe të paanshëm të ofertave, duke mos verifikuar dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë, duke mos hetuar dokumentet e dyshimta dhe duke mos kërkuar sqarime për çmimet jonormalisht të ulëta, veprime këto që kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin përfundimtar të procedurës së prokurimit.

Për më tepër, paraqitja e të dhënave të rreme dhe e dokumenteve të falsifikuara nga OE Gani Krasniqi B.I. përbën shkelje të rëndë ligjore dhe cenon parimet bazë të prokurimit publik, përkatësisht parimin e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme.

Andaj, kërkojmë nga OSHP-ja që, përveç anulimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së dhe kthimit të lëndës në ri-vlerësim, të marrë parasysh edhe përgjegjësinë ligjore të OE Gani Krasniqi B.I. dhe të veprojë konform nenit 99.2 të LPP-së, duke inicuar procedurën për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurim publik.

Me respekt,

Auto Europa Cars sh.p.k. & N.T.SH. EUROPA – Batri Ademi B.I

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet ankimore: E kemi shqyrtuar Kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimet e juaja ankimore janë të pa bazuara, bazuar në sqarimet si më poshtë. - Sa i përket pretendimit rreth inxhinierit të elektroteknikës me z. Bujar Gjocaj, i kemi shkruar email zyrtar për sqarim, dhe nga z. Bujar Gjocaj, e kemi pranuar konfirmimin me shkrim se e ka nënshkruar para kontratën me

kompanin Gani B.Krasniqi B.I.- D.P.Z "Suzuki", shih emailin me poshtë: gjeni emailin dhe një deklarat te bashkengjitur ne kerkesen per rishqyrtim.

Sa i perket pretendimet rreth Gmimeve jo normalisht te Uleta ne oferten e Gani B.Krasniqi B.I.- D.P.Z "Suzuki", konsiderojmë se ky pretendim eshte e pa bazuar, duke marre për bazë Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, ku specifikohen tre parakushte kur një oferte mund te konsiderohet si Jo-Normalisht të Ulët. i. çmimi ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. 4 çgmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. | janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Oferta Gani B.Krasniqi B.I.- D.P.Z "Suzuki", nuk e kemi trajtuar Jo-Normalisht të Ulët, meqenëse nuk është plotësuar Kushti i trete: janë dorëzuar te pakten 3 (TRE)tenderë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 01.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1155, ndërsa me datë 16.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1155, me rekomandimet si në Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEAuto Europa Cars SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1155 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 1155/25 është se parakontrata e ofruar nga OE i rekomanduar e lidhur mes OE dhe z.B.Xhocaj, nuk është e nënshkruar nga vet z.Xhocaj, dhe se nënshkrimi i z.Gjocaj është marr nga një parakontratë tjetër copy/paste dhe është vendosur në këtë parakontratë.

Për këtë pretendim OE ka ofruar si provë emailat, pyetjen e OE drejtuar z.Gjocaj dhe përgjigjen e z.Gjocaj ku i njëjti deklaroi se nuk është pjesë e asnjë OE për këtë aktivitet të prokurimit.

Në anën tjetër AK ofron provë deklarate/email bnga z.Gjocaj ku deklaroron se parakontrata është nënskruar në prani të palëve.

Pas analizimit të shkresave të lëndës kemi gjetur se dy emailat si ajo e ofruar nga OE ashtu edhe nga AK, janë nga email adresa e njëjtë, megjithatë dy emailat janë kundërthënës me njëri tjetër.

Mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore është i bazuar, duke uju referuar edhe vendimeve të OSHPs-ë të cekura nga OE ankues vendmet 1060/23 dhe 368/24.

Eksperti shqyrtues rekomandon që në rast të rivlerësimit eventual , AK të kërkojë sqarime dhe konfirmim se cili email NUK është i vërtetë, apo pse kemi dy emaila kundërthënës me njëri tjetër nga i njëjti email.

Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues se i njëjti ka dëshmi se z.Gjocaj ka qenë nën presion që ndrysojë deklaratën sa i përket parakontratës, në cilësi të ekspertit shqyrtues nuk kemi kapacitet teknik për të vërtetuar një gjë të tillë, mirëpo OE ankues mund të drejtohet organave kompetente.

Pretendimi nr.2

OE pretendon se parakontrata e ofruar me z.Xhaferi mban numrin e këtij prokurimi dhe datës 20.09.2025 , ndërsanjoftimi për kontratën për këtë aktivitet të prokurimit është publikuar me 06.10.2025.

Pas analizimit të shkresave të lëndës , në cilësi të ekspertit shqyrtues mund të konfirmojmë se datat e këtyre dokumenteve vërtetë janë ashtu siq pretendon OE ankues, megjithatë nuk mund të konfirmojmë nëse parakontrata dhe data 20.09.2025 ka qenë gabim teknik apo diçka tjetër.

Pretendimi nr.3

OE ankues sipas ankesës 1155/25 pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar për disa pozicione cmime nga 100% deri afër 1000% më të ulata se cmimet reale të dregut, duke ofruar si dëshmi disa cmime të këtyre pjesëve nga disa dyqane online.

AK në refuzim të kërkesës për risqyrtim është përgjigjur se në rastin konkret janë pranuar vetëm dy oferta dhe nuk mund të zbatohet formula e RRPP-së ku kërkohet që cmimi të jetë 30% më i ulët se mesatarja e ofertave dhe 10% më i ulët se cmimi i dytë me rend.

Pas analizimit të shkresave të lëndës ne kemi hulumtuar përmes internetit dhe kemi gjetur se vërtetë cmimet reale të tregut për pozicionet e caktuara janë nga 100% deri 500% më të larta e cmimet ofruara nga OE i rekomanduar.

Po ashtu sqarojmë se Rregullat për tender jo normalisht të ulët , përveq formulës së cekur nga AK, parshohin se cmimi jo normalisht i ulët mund të jetë edhe për një pozicion të vetëm.

Andaj rekomandojmë që në rast të rivlerësimit eventual AK të kërkojë sqarime nga OE në fjalë se si do të arrij të kthejë furnizimin/montimin e pjesëve me cmimet e ofruara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyruar për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues konstaton se lidhur me pretendimin nr; 1, ne Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr, 2 është kërkuar: 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë stafin profesional për realizimin e kontratës, si në vijim: Tre (3) automekanik; Një (1) inxhinier i mekanikës me diplomë të nivelit bachelor; Një (1) inxhinier i elektroteknikës. Si Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar Për inxhinierin e mekanikes dhe inxhinierin e elektroteknikës, kërkohen: 2. Dëshmitë: Për 3 automekanikë kërkohen Kopje të diplomave të shkollës së mesme, Kopje të kontratave ose para kontratave me punëdhënësin. Kopja e diplomës niveli bachelor dhe kontrata ose para kontrata me punëdhënësin. OE i rekomanduar për kontratë Gani B. Krasniqi B.I., për këtë kriter në këtë aktivitet te prokurimit ka prezentuar para kontratën te lidhur me inxhinierin e elektroteknikës z.Bujar Gjocaj. Operatori Ekonomik ankues Auto Europa Cars SH.P.K me datën 07.11.2025 bënë kërkesë për rishqyrtim pran AK-së, me pretendimin se parakontrata në mesë OE-së te rekomanduar për kontratë Gani B. Krasniqi B.I. dhe inxhinierit te elektroteknikës z.Bujar Gjocaj, nuk është e nënshkruar ne prezenc te palve. Pas pranimit te kërkesës për rishqyrtim nga OE-ja ankues, Autoriteti Kontraktues Ministria e Shëndetsisë, konform LPP-së nenit 52, paragrafit 7 ku citohet *7. Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit.* Me datën 13.11.2025 permes emailit zyrtar AK-ja kërkone sqarim nga inxhinierit z. Bujar Gjocaj; *“I nderuar z. Gjocaj. Ju njoftojmë se në kuadër të aktivitetit të prokurimit “Servisimi i automjeteve të MSH-së – RITENDER- me numër prokurimi: 206-25-8990-2-2-1, OE Gani B. Krasniqi B.I. me emër tregtare D.P.Z “Suzuki” ka dorëzuar një Para Kontratë të lidhur me ju. Bashkangjitur gjeni Para Kontratën, dhe ju lutemi qe të na konfirmoni nëse e keni nënshkruar këtë Para kontratë të bashkangjitur”.* Me datën 17.11.2025 permes emailit z.Gjocaj përgjigjet citat *“Te nderuar, deklaroje se Unë Bujar Gjocaj me numer personal: 1003528908, me adrese ne Prishtine ,me profesion Inxhinier i Elektroteknikës. Deklaroje se kamë nënshkruar para kontrata me kompanin Gani B.Krasniqi B.I.- D.P.Z “Suzuki” me numër unik identifikues; 810326307,Për projektin me Titulli: "Servisimi i automjeteve te MSH-se RITENDER, e numer te Prokurimit: 206-25-8990-2-2-1. Unë deklaroje*

se e kema lexuar dhe kuptuar në tërësi para kontratat e prezentuara nga kompanin Gani B.Krasniqi B.I.- D.P.Z "Suzuki" dhe siguroj se para kontrata është nënshkruar në prezenc të dy palve, Dhe konfirmoj se me këtë kompanin kemi bashpunim kontraktuale'' P.SH konstatone që, pretendimi ankimore me nr; 1, të ankuesit kundrejt OE të rekomanduar për kontratë është e pa bazuara. Pasi që AK-ja ka kryer kontroll efektive të dokumentacionit të dorzuar në ofertë nga OE-së i rekomanduar për kontratë sikurse parashihet në nenin 52 par 7 i LPP-së, mirpo PSH thekson se në rast se çdo pal përfshier edhe OE ankues ka dyshime mund ti drejtohet organeve gjegjëse- konpentete për vërtetim të më tejme kur shfaqen dyshimet sikurse në këtë rast.

Lidhur me pretendimin nr; 2, Paneli shqyrtues konstatone se parakontratë e lidhur në mes të OE-së Gani B. Krasniqi B.I., dhe Inxhinierit të mekanikës z.Adnan Xhafer, përmban numrin e prokurimit, titullin e aktivitetit të prokurimit, dhe është e lidhur për për këtë aktivitet të prokurimit sipas titullit të kontrates . Lidhur me pretendimin e OE-së ankues se parakontrata përmban datën 20.09.2025, para njoftimit për kontrat, PSH, konsideron se ky mund të jetë gabim teknik i lëshuar gjatë perpilimit të parakontratës dhe nuk bënë ndonjë ndryshim material apo aspektin e tenderit në fjalë, por përmban vetëm devijime të vogla, Neni 59, paragrafi 4. *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderinë fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.* Ku sikurse në Kërkes për rishqyrtim AK e ka konsideruar si devijim të vogël andaj pretendimi ankimor është pjesërisht I bazuar

Lidhur me pretendimin nr; 3, Paneli shqyrtues konstatone se pretendimi ankimor ku thekson se OE-ja i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmimi jo-normalisht të Ulët. Sqarojm se OE, anku ka nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo prove në kërkes për rishqyrtim e as në ankes pran OSHP-së si: faturë, profatur, ofertë apo ndonjë dëshmi të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara lidhur me pozicionet e pretenduar se nuk janë çmimi sipas tregut, por vetem ka pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmimi normalisht të ulët. Po ashtu Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës. Dhe në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë dy Operator Ekonomik, dhe në këtë raste nuk janë përmbushur të gjitha kushtet që të cilsohet si ofert jo-normalisht të Ulët.

Poashtu Paneli Shqyruer vuri në zbatim nenin 6 të LPP-së (ekonomikitetin dhe efikasitetin), duke analizuar çmimet ku OE i rekomanduar ka çmimin më të lirë se OE ankues.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues duke u bazuar në nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së dhe duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuara, por e pamjaftueshme të ndryshoj epilogun përfundimtar të kësaj vendimarrje të AK. Andaj, njëfotimi mbi vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull '*Servisimi i automjeteve të MSH-se RITENDER, e numer të Prokurimit: 206-25-8990-2-2-1* e inicuar nga AK-ja Ministria e

Shëndetësisë , mbetet ne fuqi

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Auto Europa Cars SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: